REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ

KËSHILLI I BASHKISË

Datë 24.07.2026 Prot.57 (pesëdhejtëeshatëë)

Protokoll nr. 57

I mbajtur sot më datë 24.07.2026, në mbledhjen e radhës të Këshillit Bashkiak Maliq, në sallën e mbledhjeve të këshillit të bashkisë, ora 10:00.

Rend Dite:

1.Hapja e mbledhjes (korumi, miratimi i rendit të ditës, vendimet e mbledhjes së kaluar);
2.Deklarimi i konfliktit të interesit nga këshilltarët, për vendimmarrjen lidhur me çështjet e rendit të ditës.
3.Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar datë (25.06.2026)
4.P-V "Për miratimin e Ndihmës Ekonomike deri në masën 6% të fondit për muajin qershor 2026";
5.P-V "Për dhënie ndihme financiare për famije në nevojë";
6.P-V "Për dhënien e ndihmës financiare përfituesve nga projekti *"Shërbime mbështetëse dhe fuqizuese në familje për të moshuarit dhe personat ma aftësi të kufizuar"* financuar nga Fondi Social";
7.P-V "Për detajimin e fondeve sipas aktit nomrativ nr.2 datë 30.06.2026'';
8.P-V"Për miratimin e tavaneve përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2027-2029 në nivel programi";
9.P-V "Për disa shtesa dhe ndryshime në VKB-në nr.2.datë, 08.01.2026 "*Për miratimin e numrit të punonjësve, nivelin e pagave të adminstratës së Bashkisë Maliq dhe strukturave të tjera për vitin 2026";* i ndryshuar.
10.Diskutime të tjera.

Këshilltarë të pranishëm në sallë:

Ornildi Demollari; Pranvera Begolli; Klea Baçi; Petrit Kupe; Dritan Çami; Floreta Zaçe; Idlir Limllari; Selami Muço; Fevri Sherifi; Krisitna Malelli; Xhuana Hoxhallari; Dalina Krekas;Yllson Ibrahimllari; Neresida Shindo; Lulëzim Hoxhaj; Server Xhuti; Faslli Zholi; 17(shtatëmbëdhjetë) këshilltarë.

Mungesa: Rovena Terolli; Aramando Dautllari; Eriseld Jonusllari; Enida Avdolli; Gentiana Drabo; Marinathi Avrami; Danjela Ibrahim; Albina Xhejo; Andonaq Risto; Plator Çollaku; Ilia Xhuti; Eglantina Balli; Almir Elezi; Marjeta Xhelollari; 14 (katërmbëdhjetë).

Të pranishëm nga Administrata: Zv/Kryetari i Bashkisë;z Eridion Rustemi; Drejtore e Financës dhe buxhetit;znj.Almira Muka; Përgjegjës i Sektorit të Pyje-Kullota; z.Klarsen Brako; Përgjegjës i Zyrës së Strehimit; z.Ledion Mullalli; Përgjegjese; Drejtore e Shërbimit Social;znj.Ermanda Petriti;

Ornildi Demollari: Fillojmë? Ju lutem, zini vendet, fillojmë. Mirëdita të gjithëve, të nderuar kolegë, i nderuar nënkryetar i bashkisë, të nderuar pjesëmarrës. Po fillojmë këtë mbledhje të radhës të këshillit të bashkisë, sikurse kemi njoftuar disa ditë përpara edhe në respektimin e afatit të njoftimit. Fillimisht bëjmë një verifikim të korumit, për të para se të vijojmë me rendin e ditës. Dhe, me sa shoh, kurumi realizohet pasi në sallë ndodhen 16 këshilltarë, kështu që mund të vijojmë me rendin e ditës. Tani ju ftoj të miratojmë rendin e ditës, por do të desha të shtonim një material i cili na ka ardhur pak më mbrapa, që është projektvendim për miratimin e listës përfundimtare të familjeve përfituese të projektit "Përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitete të varfra dhe të pafavorizuara" për vitin 2026. Është një material që na erdhi disa ditë më mbrapa. Do të kërkoja mirëkuptimin e këshillit që ta shtonim në rendin e ditës, bashkë me pikat e tjera. Atëherë, e kalojmë në votim rendin e ditës, duke shtuar edhe këtë pikë. Kush është dakord? 16 vota pro.

Kundër? Nuk ka?

Abstenim nuk ka? Miratohet rendi i ditës. Faleminderit. Më lejoni t'ju njoh me vendimet e mbledhjes së kaluar: janë gjithsej 17 vendime, 11 janë me karakter normativ dhe 6 me karakter kolektiv, të cilat janë kthyer në vendime tashmë. Këto me karakter normativ, pasi kanë marrë edhe dakordësinë e institucionit të prefekturës, janë kthyer në vendime. Tani ju ftoj të miratojmë protokollin e mbledhjes së kaluar, një procedurë standarde që e bëjmë gjithmonë. Kush është dakord me protokollin e mbledhjes së kaluar? 16 vota pro.

Kundër? Nuk ka? Abstenim nuk ka? Miratohet protokolli i mbledhjes. Faleminderit. Dhe shkojmë tek pika 4 e rendit të ditës, që është projektvendim për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi 6% për muajin qershor 2026. Komisioni?

Faslli Zholi:Përshëndetje, kolegë këshilltarë, përshëndetje përfaqësues i ekzekutivit, nënkryetar i bashkisë, përshëndetje pjesëmarrës. Ne si komision i ndihmave ekonomike u mblodhëm me telefon, sepse për arsye pushimesh diskutuam.

Yllson Ibrahimllari: Listat kanë pasur gjithmonë probleme, janë bërë edhe objekt të kërkesë padive apo dërgimeve në prokurori dhe në gjykatë. Mendoj që jemi në një fazë të cilën kemi një shkëputje midis këshilltarëve dhe realitetit lokal, këshilltarëve dhe kryetarëve dhe kryesive të fshatrave, dhe nuk e bëjmë dot një seleksion të të gjithë listës për qendër. Vota, për të mos e zgjatur dhe për të mos kaluar individualisht, kurrë nuk kam qenë për t'u marrë me ata njerëz, sepse unë mendoj që, unë dhe kolegët e mi mendojmë që këshilli bashkiak duhet të hapë hapësira për vende pune dhe jo të jetë ai që shikon me lupë listën e 6%. Kjo listë është e mangët, shumë shumë nga subjekti që unë përfaqësoj këtu. I konsultuar gjerë e gjatë, ata janë dhe me emra të

veçantë të cilat unë nuk po i bëj prezent. Konsiderohet si një listë patronazhistësh. Unë s'e përdor këtë fjalor kurrë, as me kolegët, as nga ana profesionale, por vendimi jonë për të votuar kundra këtë 6%. Ju faleminderit.

Ornildi Demollari:Nënkryetar, kishte gjë? Kemi gjë, drejtoreshë?

Zv/Kryetari i Bashkisë;z Eridion Rustemi: Asgjë.

Ornildi Demollari:Në fakt, domethënë, pyetja dhe shqetësimi ishte që a është listë patronazhiste?

Yllson Ibrahimllari: Jo, jo, s'është kështu. Është listë e mangët, listë e pa filtruar mirë dhe me njerëz të cilët nuk plotësojnë kriteret për të marrë 6%. Për të mos thënë që s'janë as prezente. Nëse doni, unë do t'ju kërkoj subjekteve të koalicionit opozitar të sjellin në mënyrë nominale në çdo 6% të propozuar nga ju, atje ku kanë kontestimet. Faleminderit.

Drejtore e Shërbimit Social;znj.Ermanda Petriti:Përshëndetje.Duke qenë se ndihma ekonomike është një mbështetje që i jepet familjeve në nevojë, unë nuk do isha dakord që kjo të mos miratohet. Në qoftë se ka propozime të veçanta për persona të veçantë dhe problematika, ne nuk mund të djegim 150 familje të tjera, sepse mund të kemi një familje e cila supozohet që nuk plotëson kriteret. Në qoftë se ka, do të doja një kërkesë ose diçka me shkrim që disa familje nuk janë për t'u trajtuar nga 6%, që t'i shikojmë rast pas rasti dhe pastaj të vendosim që në qoftë se duhen larguar apo nuk duhen larguar këto familje. Por nuk mund të lejoj si shërbim social që ne të penalizojmë një numër kaq të madh familjesh për një ose dy të cilat supozohet që kanë problematika.

Faslli Zholi: Unë desha të sqaroj një diçka. Unë jam dakord me listat, edhe vajza dhe kolegu im, doktor Yllsoni, që ka mangësira. Ne i kemi diskutuar edhe këtë radhën në komision, por dua të jem në këtë fjalë që ne po ta lëmë pa miratuar këtë, do të thotë që do penalizojmë shumë familje. Mund të kemi një, dy apo tre aty. Jam dakord me vajzën që t'i shikojmë, t'i pastrojmë dhe të mos ndodhin më këto gjëra, sepse nuk mund t'i penalizojmë shumicën me dy, tre emra që mund të jenë aty dhe pesë emra që mund të jenë. Për këtë mendoj që ta votojmë, se mos e lëmë mangut këtë. Kështu është mendimi im. Faleminderit.

Ornildi Demollari: Faleminderit.Kemi gjë tjetër këtu? Nënkryetar? E kalojmë në votim, ju lutem. Kush është dakord? Atëherë, me 13 pro dhe me 3 kundër, projektvendimi miratohet me shumicë të thjeshtë. Faleminderit. Kalojmë tek pika tjetër. Me 13 pro dhe 3 kundër. Kalojmë tek pika tjetër, ju lutem. Projektvendim për dhënie ndihme financiare për familjet në nevojë. Jemi tek pika 5. Komisioni, ju lutem.

Faslli Zholi: Tashti, edhe pika 5 për dhënien e ndihmës financiare. Unë kam bërë edhe nja disa pyetje aty në atë dokumentin. Çupa që është këtu, mundet të na i shpjegojë për ta marrë vesh edhe anëtarët e këshillit më mirë këtë situatë. Fjala për juve.

Ornildi Demollari: Kemi ndonjë gjë?

Pranvera Begolli: Po ta kalojmë te miratimi, sepse atje është një relacion që shpjegon ato familje që kanë nevojë për atë ndihmë dhe për relacionin. Në qoftë se ndonjëri ka ndonjë kundërshtim, por nuk e besoj, se me relacionin është shpjeguar arsyeja pse ata persona duhet të marrin këtë ndihmë.

Ornildi Demollari: Dakord. Nënkryetar? Kishte gjë? Jo. E kalojmë votim, ju lutem. Kush është dakord? 16 vota pro.
Kundër? Nuk ka?
Abstenim nuk ka? Me 16 pro, miratohet. Faleminderit. Kalojmë tek pika 6 e rendit të ditës, që është projektvendim për dhënien e ndihmës financiare përfituesve nga projekti "Shërbime mbështetëse dhe fuqizuese në familje për të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuar", financuar nga fondi social. Tek pika 6. Jo, në fund. Në fund. Kemi këtu ndonjë pyetje, ndonjë koment? Tek 6-ta. E kalojmë votim, ju lutem. Kush është dakord?16 vota pro. Kundër? Nuk ka? Abstenim nuk ka? Me 16 vota pro, miratohet. Faleminderit. Kalojmë tek pika 7 e rendit të ditës. Projektvendim për detajimin e fondeve sipas aktit normativ numër 2, me datë 30. 06. 2026. Është një detajim fondi. Ndoshta drejtoresha e financës ose nënkryetari? Komisioni, më fal, po. Më fal.
Petrit Kupe: Komisioni e pa paraprakisht projektvendim. Duke konsultuar me drejtoreshën e financës, bëhet fjalë për një fond në bazë të vendimit të Këshillit të Ministrave, me vendimin numër 2, 30.06. 2026, të një akti normativ, i cili shoqërohet me një fond të detajuar për transfertën e pakushtëzuar dhe për transfertën e pakushtëzuar sektoriale. Drejtoria e financës ka bërë ndarjen e pjesës së parë për ndërtim zyra turizmi, për blerje mobile pajisje për zyrën e turizmit, infopoint, dhe blerje korse bari. Për transfertën tjetër, ishte menduar që të bëhej rikonstruksioni i objektit të zjarrfikëses, por nga ana e financës sot paraqitet një ndryshim. Ky fond i përcaktuar për rikonstruksionin, në bazë të vendimit të Këshillit të Ministrave të marrë ditën e fundit, përpara se të dilte ky projektvendim, do të përdoret për pagesat dhe për orët e natës. Kështu që ndryshon destinacioni i këtij fondi. Kjo është një masë akoma më e mirë në mbështetje të zjarrfikësve, të cilët përballojnë, siç e dini, vështirësitë më të mëdhaja të kësaj periudhe. Prandaj ne jemi dakord që të miratohet ky projektvendim i detajuar.
Ornildi Demollari: Faleminderit. Pra, kjo rehabilitim godina ndryshohet me atë?E kuptova. Kemi gjë tjetër? E kalojmë votim, ju lutem. Kush është dakord? 16 vota pro.
Kundër? Nuk ka? Abstenim nuk ka? Me 16 vota pro, miratohet. Faleminderit. Dhe kalojmë tek pika 8 e rendit të ditës, që është projektvendim për miratimin e tavaneve përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm për harkun kohor 2027-2029, në nivel programi.
Mbledhjes i bashkohet dhe znj.Nerseida Shindo, shkon në 17 numri i Këshilltarve të pranishëm në sallë.
Petrit Kupe: Ky projektvendim bën fjalë për miratimin e tavaneve përfundimtare për periudhën 2027-2029 dhe shpenzime të parashikuara nga drejtoria e financës. Dhe pikërisht ky projektvendim është një arsye që mbledhja është kryer përpara kohe, sepse kërkon një afat të

caktuar. Prandaj u mblodhëm në datën 24. Ne jemi dakord që ky projektvendim të kalojë sa më parë pranë Ministrisë së Financave, për ta patur parasysh në parashikimin e shpenzimeve financiare për vitet e ardhshme të bashkisë së Maliqit, apo siç do të jetë.

Ornildi Demollari: Faleminderit. Kemi ndonjë pyetje këtu, ndonjë koment?

Yllson Ibrahimllari:Në fakt, ky projektvendim duhet të shtrihej deri në 2027-ën, besoj do kishte më shumë vlerë edhe me ndarjen e re territoriale. Faleminderit.

Ornildi Demollari:E kalojmë votim atëherë? Kush është dakord? 17 vota pro,
Kundër? Nuk ka? Abstenim nuk ka?
Miratohet me 17 vota pro. Kalojmë tek pika tjetër e rendit të ditës. Pika 9, projektvendim për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e Këshillit Bashkiak numër 2, datë 08. 01. 2026, për miratimin e numrit të punonjësve, nivelin e pagave të administratës së bashkisë Maliq dhe strukturave të tjera për vitin 2026, i ndryshuar. Komisioni?
Petrit Kupe: Megjithëse e kemi sugjeruar që ndryshimet të mos jenë kaq të shpeshta në strukturë, megjithatë nga ana e bashkisë janë paraqitur disa ndryshime në strukturë dhe paga. Bëhet fjalë në pikën një, për ndryshim të emërtimit të punonjësve nga sektori i politikës sociale dhe diasporës, pra në dy punonjës. Në sektorin e bujqësisë parashikohet një rritje page për një pozicion. Dhe kemi dy shtesa të numrit të punonjësve që mendohet të pasqyrohen në strukturë. Në sektorin mbështetës teknik ndriçimi audio, domethënë në shtëpinë e kulturës, që po rritet numri i punonjësve, siç duket ka shumë nevojë, dhe një trajner i moshave për njësinë e Pojanit. Gjithashtu kemi dhe një rritje page në punëtor krahun në Mesmal. Këto janë projektvendime që janë paraqitur, për të cilat ka dhe një relacion. Ne jemi dakord për miratimin e këtyre.

Ornildi Demollari: Faleminderit. Komisioni, kemi gjë? Po.

Zv/Kryetari i Bashkisë;z.Eridion Rustemi: Mirëdita të gjithëve. Për propozimin që ka ardhur për ndryshimin e strukturës, deri diku bashkia ka qenë edhe pak si e detyruar, për shkak edhe të një kërkese që është bërë nga Ministria e Shtetit dhe e pushtetit vendor për ndryshimin e një emërtimi në pozicionin e strukturës të shërbimit social, ku emërtimi ju e keni dhe të sqaruar në relacion, të bëhet ndryshimi nga sektori i politikave sociale të ndryshojë në emërtim të bëhet sektori i politikave për diasporën. Për ato ndryshimet e tjera e sqaroi zoti Kupe, këshilltari, por ne kemi dhe një kërkesë tjetër. E kemi pasur si pozicion në strukturën e bashkisë Maliqit, këshilltar të kryetarit, dhe kërkojmë që ky pozicion të jetë këshilltar i jashtëm i kryetarit, sepse është një pozicion që në disa pika të aplikimit të projekteve për disa projekte për fonde në këto të Bashkimit Europian, kërkohet një këshilltar i jashtëm i kryetarit dhe e kemi si të domosdoshme këtë pjesë. Ja kërkoj këshillit që të miratojë një pozicion dhe nuk është shtuar këtu, është një pozicion në njësinë administrative vreshtas punonjës mirëmbajtje për shkak të ngarkesës në punë. Ai është me shtatë orë aty. Të kërkoj që me mirëkuptimin e këshillit të bëhet me tetë orë për shkak të asaj ngarkesës që ka ai në strukturën që përfaqëson. Faleminderit.

Pranvera Begolli: Kryetar, aktualisht ju keni të drejtë, por ne në projektvendim kemi këto që kemi diskutuar në Komisionin e Financës dhe nuk e kuptoj që në qoftë se kërkoni të bëni ndryshime për këshilltarë, ta sillni me projektvendim. Duhet të sillni me projektvendim që të vendoset arsyeja pse relacioni, pse edhe paga që përfaqëson. Ndryshimi pse kalon nga këshilltar në këshilltar jashtë.

Ornildi Demollari: Po. Faleminderit. Po.

Yllson Ibrahimllari: Ju faleminderit, kryetar. I nderuar nënkryetar, shoh këtu në ndryshimet që propozoni politikave, specialisti i politikave sociale plus diasporë. Në fakt, për aq sa di unë latinisht, mjaftueshëm besoj, s'kam as kolegen sot që edhe mund të debatonim në këtë fushë, dija do të thotë me shpërnda dhe spore spore të kërpudhës. Unë besoj që në gjuhën shqipe fjala më e mirë për këtë sens do të ishte mërgata, ata që janë të mërguar nga vendi, sesa këto termat kështu një çik miksturë. E përveç miksturës të diasporës nga dija dhe spore, tani na vjen dhe mikstura tjetër, punonjës social plus diaspora, kapacitete shumë të mëdhaja nga minus infiniti te plus infiniti. Pjesa tjetër, çfarë nënkupton kjo? Punëtor krahu mirëmbajtje Mesmal. Rruga nga Triurat në Mesmal se është bërë dhe një çik ngërç kjo për të treguar edhe dashurinë nga zona, po me të vërtetë ajo zonë meriton një çik më shumë përkushtim dhe vëmendje. Ju i nderuar, e keni vizituar disa herë. Unë po të them, rruga nga Triurat deri në Mesmal nuk ka asnjë kanal kullues në krahun e sipërm të Karanxhatës dhe sot po të duash të shkojmë bashkë që mos kthehet pastaj që e kërkon doktori, e bën doktori, doktori bën ngërçe këtej andej. Futini në punë ata që paguajmë në Selcë, në Velçan dhe në Mesmal. Ca krushqit e mi, ca miqtë e vjetër të Verës. Nëse shtrojnë për rroga, të shkojnë edhe të heqin ndonjë lopatë, se më shumë e pastroj unë atë rrugën ku ngjitem sesa pastrohet kanali për të kaluar ujë. Dhe ajo rruga që vjet bëmë debat këtu, ajo rruga që i kërkova një komision hetimor Verës këtu, ajo rruga që ka ardhur, të ka ardhur një ankesë sot nga një qytetar që është çeduar muret e shtëpisë dhe i ka marrë kasollen lumi dhe nuk është evidentuar. Sepse emergjencat civile thonë që nuk e kemi ne për ta bërë dhe drejtoria e bujqësisë thotë dhe drejtoria e bujqësisë asgjë personale me ju dhe drejtoria e bujqësisë thotë ne vlerësojmë vetëm tokat bujqësore. Mësojeni një çik se nuk guxon dhe edhe në atë njohje sa kemi vërdallë, nëse një deputet qoftë edhe i opozitës i telefonon kryeministrit, telefoni hapet. Mësojeni një çik drejtorët e kësaj bashkie që këshilltarëve ju hapen telefonat se është më e vështirë po mos ta hap unë kur thyen këmbën sesa ai që është duke vaditur edhe nuk hapet. Megjithatë që të mos e zgjasim shumë këtë lloj problematike. Kur i marrim, unë nuk jam kundra. Unë jam që edhe ajo që ju thatë ta shtojmë këtu dhe ndoshta dhe tërhiqemi 10 minuta komisioni ta thotë fjalën e vetë. Edhe ne si komisione duhet t'i sjellim me relacione dhe ne ato që bëjmë. Unë jam për t'i miratuar të gjitha. Ju kemi miratuar çdo gjë në strukturë. Por nëse do thërresim në shtator siç kemi rënë dakord dhe me kryetarin e bashkisë, çdo drejtori këtu për interpelancë mos i vijë keq dikujt sepse po sulmohet me të padrejtë. Se po të jetë për t'u sulmuar me të padrejtë e realizon ai zotëria aty jashtë nga oborri vetëm me hyrjet e me daljet e punonjësve në dikaster. Unë nuk ju përkas atyre njerëzve që në edukimin tim familjar, personal apo profesional i mat njerëzit me sa orë rrinë në

punë. Unë jam shumë liberal për këtë. Unë i mat për aq punë sa prodhojnë. Por të kesh 3 km rrugë që 25 vjet andej dhe këtej pushteti nuk është hequr një lopatë për ta pastruar kanalin kullues të rrugës dhe ne shpenzojmë çdo vit fonde nga buxheti dhe të mos realizohet pastaj ngelet që na kanë ngelet që i kemi gjetur një punë një njeriu dhe jo punës njeriun e duhur. Ju faleminderit.

Zv/Kryetari i Bashkisë;z.Eridion Rustemi: Faleminderit. Doktor, unë ju falenderoj për të gjitha ato që juve parashtroni në Këshillin Bashkiak. Disa prej tyre qëndrojnë, disa mendoj që nuk qëndrojnë. Në rrugën nga Tre Ura deri në Mesmal, pothuajse para një muaji, bashkia e Maliqit në bashkëpunim me Ministrinë e Mbrojtjes ka kryer një investim në mirëmbajtjen e asaj rruge që edhe juve besoj e keni parë sepse jeni një nga këshilltarët që e vizitoni shumë shpesh zonën që përfaqësoni edhe për këtë meritoni respekt. Për sa i përket produktivitetit të punonjësve të mirëmbajtjeve të rrugës në punë në një bashki me shumë punonjës apo me disa punonjës, nuk mendoj që janë të gjithë në atë 100%-in e tyre në dhënien e kontributit në pozicionin e punës që ata përfaqësojnë. Ne patjetër që kritikat tuaja do t'i marrim parasysh edhe do t'ia paraqesim strukturave tona për të munduar që të rregullojmë ato parregullsi apo pakënaqësi që juve konstatoni. Por dua të them edhe njëherë që vëmendja e bashkisë së Maliqit për rrugën e Mesmalit nga Tre Ura deri në Mesmal, posaçërisht këtë vit ka qenë vëmendje e konsiderueshme. Faleminderit.

Yllson Ibrahimllari:E shtuar ka qenë vëmendja, është çakulluar rruga, po nuk funksionon kanali. Nuk thashë të kundërtën. Më fal.

Ornildi Demollari: Faleminderit. Kemi gjë tjetër?

Yllson Ibrahimllari: Ose më jep mundësinë mbas dy orësh të ta çoj të gjithën me video. Faleminderit.

Ornildi Demollari: Kemi gjë tjetër? E kalojmë në votim materialin, por duke shtuar duke shtuar ndryshimin.

Lulëzim Hoxhaj: Unë jam dakord. Jam dakord duke u bashkuar edhe me vërejtjet që bëri dhe ju thoni dhe ndonjë tjetër këtu. Jam dakord me vërejtjet. Bashkohemi me atë dhe siç kemi vepruar dhe herë të tjera e këtej kur është paraqitur ndonjë gjë siç u paraqit nga nënkryetari pavarësisht se nuk është bërë vendim unë mendoj që të të votohet edhe ajo kërkesa e nënkryetarit të shtuar punonjësit e vreshtasit. Po pra. E vreshtasit ajo e këshilltarit nga nga s'ka ndonjë s'ka ndonjë kuptim të mos votohet. Ka qenë.

Ornildi Demollari: Po po pra po. E kalojmë votim me shtesat që propozoi nënkryetari. Kush është dakord? 17 vota pro
Ju lutem. Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet. Faleminderit. Kalojmë tek pika tjetër. Është materiali që shtuam në rendin e ditës në fillim të mbledhjes. Përkatësisht për vendim për miratimin e listës përfundimtare të familjeve përfituese të projektit përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitete të varfra dhe të pafavorizuara. Po.

Faslli Zholi: Tashi neve si komision e morëm njoftimin me vonesë dhe me djalin kontaktuam edhe ky është një material që e keni të gjithë tani përpara. Mirë është të miratohet për të mos e humbur atë fond. Djali për detaje më tepër është Ledioni këtu. Mund t'i sqaroj dhe këshilltarët. Faleminderit.

Ornildi Demollari: Po Petrit?

Petrit Kupe: Patjetër që duhet ta miratojmë sepse paraprakisht është miratuar një listë. Tani është shoqëruar dhe me fondet. Por unë vazhdoj të ngul këmbë në ajo pjesa ku këtu thuhet për përmirësimin e banesave ekzistuese për komunitetet e varfra dhe të pafavorizuar. Domethënë sipas si preventimi mbarojnë këto familjet e varfra të pafavorizuara. Është bërë një punë e mirë në këto vite. Vënë rreth 320 familje, por ngelen ngërç problemi familjet me të vërtetë të varfra. Neve ishim në një seminar në Nildin edhe Gjritin para pak kohësh dhe u ballafaquam dhe me bashkinë e Devollit. Këtë kategori që ne ngulim këmbë t'i trajtojmë, bashkia e Devollit i trajtonte. Bile në mbledhjen e mëparshme është lënë edhe nga porosi dhe nga këshilli dhe nga kryetari i bashkisë që të përgatiten kritere për të favorizuar ato familje aq të varfra. Është lënë dakord nga kryetari që të gjenden dhe fonde për të ndihmuar, por ne vazhdojmë të njëjtën valle dhe nuk po marrim asnjë masë për mbrojtjen e megjithmend të familjeve shumë të varfra. Unë jam dakort për miratimin e këtij projketvendimi, por presim që bashkia të përcaktojë një preventim dhe me këto kritere ose në të kundër unë bashkë me këshilltarët do paraqit një projektvendim në mbledhjen mbas mbledhjes së radhës në qoftë se do bëhet diçka bashkia do përgatitim një projektvendim ku ta detyrojmë të marrë përsipër zgjidhjen e këtij problemi. Besoj se dhe këshilltarët e tjerë janë dakort.

Ornildi Demollari: Po ke shumë të drejtë.

Faslli Zholi: Edhe unë jam plotësisht dakort me paraforcin. Për këtë duhet sistemuar kjo se kemi plot familje të cilat nuk plotësojnë kriterin po janë në hall dhe hallin duhet ta zgjidhim. Në qoftë se është kështu jam dakort shumë me Petrit.

Ornildi Demollari: Ne jemi fokusuar vetëm tek familjet që disponojnë një dokument pronësie të banesave të tyre ndërkohë që janë edhe aq të tjerë të cilët për një arsye apo për një tjetër nuk kanë një dokument pronësie dhe disfavorizohen në këtë në këto projekte. Po dakord. Yllson.

Yllson Ibrahimllari: Ja ta dëgjojmë njëherë zonjën.Se besoj që i kanë mjaft.

Pranvera Begolli: Kjo është e vërteta. Aktualisht derisa njerëzit vonohen për të marrë një certifikatë pronësie prej vitesh kjo është një mangësi.

Yllson Ibrahimllari: Ju e dini që këtë këtë ciklin dashuri urrejtje midis meje dhe verës është goxha i gjatë po unë besoj që Verës 27 vjet i kanë mjaftuar për të marrë nisma ligjore për t'i realizuar këto. Aq më shumë me influencat e veta që ka pasur që i ka edhe mua mund të më kishte detyruar për të marrë ndonjë nismë të tillë. Unë besoj që këshilli duhet t'i kërkojë më shumë të mos vazhdojmë kështu. Këshilli ka të gjitha mundësitë të sjellë projektvendime. Unë bashkohem me të. Ne duhet të tundemi një çik se i kemi të tëra fshatrat me kufi dhe me centralist Arushën në këtë zonën time të paktën. S'kemi asnjë lloj certifikate gjëkundi. I ngelet hatri zotërisë së emergjencave, atij të zjarrfikëses kur vijnë këtu dhe unë votoj. Ai fshatari atje më shikon. Fshatar jam vetë unë nga Velçani se mos duket si konotacion. Ai më shikon me urrejtje se unë s'kam votuar pr, a mundemi të bëjmë diçka dhe ta zgjidhim? Nuk do kalojmë asnjë shtëpi të djegur që s'e dimë e kujt është këtu. Mos ja vëmë flakën. Ose do të marrim në shqyrtim dhe shtëpinë në Velçan që e ka dëmtuar lumja. Diçka më shumë sesa lumi. O një standard o hiç fare. Kemi blerë mesin dhe e kemi federuar me Maliqin. Kemi marrë drejtorin e përgjithshëm të hipotekave dhe e kemi federuar me Maliqin. Tashi o s'bën ekipi o s'bën mesi. Na i zgjidhni ato kriteret. Më fal u plak Mesi. Dakord. Ke plotësisht të drejtë. Po unë më shumë të erdha nga krahu ty se ti je më shumë tifoz me Mesin. Unë jam me gjermanët. Atëherë mund të shkojmë drejt një iniciative ligjore, të thërresim konsulent ligjor nëse s'e bëjmë dot vetë dhe ta mbyllim njëherë e mirë këtë se lam nam. Kriter 16 vjeçar legalizimi i shtëpisë time në Velçan. Sa larg ishte nga rruga. Kur vajtëm ta kërkonim nuk ishte nuk gjendeshe rruga. Mua më pengonte legalizimet. Tani ai zotëria që e ke në krahun e djathtë për zotin Bajram në Drithas, poshta në Drithas lart ka kërkuar ndihmesën për çatinë. Ju bë Bajrami çatia. Ju bë shumë mirë. Si Bajrami janë dhe njerëz të tjerë që kanë mangësi dhe specifika ligjore. Hajde të marrim edhe për një arsye tjetër. Të më falësh nënkryetar, më falësh kryetar. Nuk është i vetmi vendim edhe po gabuam ne i këshillit bashkiak që e kemi marrë ne dhe nuk është zbatuar. Kemi dhe vendime rrugës që i kemi marrë edhe janë aty si vendime po s'i ka zbatuar njeri. Hajde të marrim një nismë ligjore. Të paktën edhe këtë mandat mos e mbyllim me turp. Të paktën të thonë që ishin ca burra ata nga fundi se nga fillimi kanë qenë më të mirë nga ne. Faleminderit.

Ornildi Demollari: Faleminderit.Nënkryetar Ledion ke gjë këtu?pothuajse i gjithë këshilli bashkohet në. Jo pothuajse po i gjithë këshilli duhet të gjejmë kriteret më fal ne duhet të gjejmë kritere për t'i kualifikuar të gjitha familjet e varfra me apo pa dokument pronësie. Po urdhëro.
Përgjegjës i Zyrës së Strehimit; z.Ledion Mullalli: Tani ky është një projekt që bëhet për të 70 vjet radhazi në bashkinë Maliq dhe shyqyr Zotit ne e kemi përfituar këtë projekt dhe kushtet kryesore të këtij projekti që janë të vendosura nga ministria është që familja duhet të ketë një dokument pronësie të cilin e lidh me banesën. Ne çfarë kemi bërë në këtë moment? Vetëm para pak ditësh ne kemi bërë një kërkesë në një organizatë humanitare e cila mund të mos ketë kritere të këtilla dhe kemi bërë një aplikim për rreth 18 familje. Në qoftë se ne do arrijmë që të

përfitojmë këtë lloj financimi do të kemi mundësi të trajtojmë disa familje të cilat të cilat nuk trajtohen nga ky projekt. Tani këto janë mundësitë për momentin.

Ornildi Demollari: Po kjo është rastësore. Sot është.

Përgjegjës i Zyrës së Strehimit; z.Ledion Mullalli: Jo dakord. Kjo është për momentin. Tani kritereve të ministrisë ne nuk mund t'i lëvizim dot sepse janë disa disa kushte të cilat i ka vendosur. Çfarë është bërë? Është bërë një lehtësim. Nuk janë futur vetëm familje të cilat kanë certifikatë pronësie, por janë futur familje të cilat banesat e tyre i kanë me formularin 01. Këto lloj lehtësirash na janë bërë duke qenë se duke ditur problematikën në terren. Ndërsa për familje të cilat nuk kanë asnjë lloj dokumenti pronësie, ajo pastaj duhet gjetur në një formë tjetër. Nuk di çfarë të them për atë pjesë.

Faslli Zholi:Më fal, ne e kemi çështjen të mirë që ministria ka kritere, po ne jemi të tërë këtu e tërë qytetarët janë të ministrisë e kemi të përbashkët, shtetin e kemi të përbashkët. Ne po kërkojmë si këshill që të instalohet për ata që janë nuk kanë dokument që është prapë faji i shtetit. Tani për këtë ky është problemi i tokës.

Petrit Kupe:Për këtë formën tjetër që po flet zotëria është folur edhe para gjashtë muajsh. Çfarë u bë gjashtë muaj? Asgjë. Ku është kjo forma tjetër? Ja ku është Devolli. Ata nuk janë në shkelës të ligjit. Po s'ka lëvizur njeri se ka marrë iniciativën se kënaqemi me ato kriteret e ministrisë.

Yllson Ibrahimllari: Atëherë unë besoj që të gjithë bashkë mund të bëjmë ndonjë gjë të mirë për këtë vend. Unë nuk besoj që neve si këshilltarë kemi marrë edhe kontakte me deputetët tanë lokalë, po themi, nuk po themi qendror dhe s'ja kemi paraqitur këtë iniciativë që ata ta ngrenë në parlament dhe ta detyrojnë me ministrinë. Në qoftë se nuk bën një VKB, të merret një VKM dhe të vazhdohet me specifikat që ka. Një udhëzim përkatës. Një udhëzim përkatës. Këtë po themi. Këtë po themi. S'po themi asgjë. T'i ndajmë dy gjëra që mos hallakatemi. E miratojmë këtë që kanë sjellë dhe e lemë hapësirën për tjetrën.

Ornildi Demollari: Patjetër, patjetër.

Yllson Ibrahimllari: Atëherë pjesën tjetër do ta hartojmë ne bashkarisht, siç kemi dhe dy propozime nga dy komisione prestigjoze që ta bëjmë me dije nënkryetarin, t'ia transmetojmë dhe kryetarit, t'ju bëjmë dhe ju si kryesi bashkarisht me dije. Përpara disa kohësh, meqë jemi në këtë fushë, Akademia e Shkencave e Shqipërisë në kuadrin e ngrohjes globale ka organizuar një seminar në muajin prill mbi përmbytjet dhe problematikat e sjella nga ato në nivelin shqiptar, duke marrë edhe përsipër, duke folur me zotërinë që është kryetar i komisionit të bujqësisë dhe zotëria tjetër që është i komisionit të hapësirë hapësinor. Kemi marrë, kemi komunikuar me prefektën e qarkut dhe duam të organizojmë në qoftë se do ta kemi të mundur një seminar me tre personalitete ende gjallë. Profesor Dhimitër Voglin që ka bërë bonifikimin e fushës së Maliqit, profesor Zydi Teqen dhe disa të tjerë që ata do t'i referojnë. Unë propozova, nëse do më dëgjohet

fjala, ajo do varet nga ekzekutivi më shumë, që ky seminar të zhvillohet workshop në nivel qoftë në platformën Zoom te qendra Dhimitër Orgocka, që në qoftë se në nëntor të mos rrimë pastaj, kjo s'është nuk ka fare ngacmueshmëri, mos themi që sot na ranë më shumë milimetra shi nga 100 vjetët e fundit, të kemi hapësirat. Pastaj ne si këshill, juve si ekzekutiv doni t'i kontrolloni drejtoritë kush është dhe çfarë bën dhe për çfarë paguhet, është në të drejtën tuaj. Aman të paktën të ketë një sensibilitet rajonal për këtë punë. Ju faleminderit.

Ornildi Demollari: Faleminderit. emi gjë tjetër këtu tek kjo nënkryetar? Janë gjithsej 43 familje. Ju lutem e kalojmë në votim. Kush është dakort? 17 vota pro.
Kundër nuk ka.
Abstenim nuk ka. Miratohet. Faleminderit. Tani përpara se të shkojmë jemi tek jemi te kërkesat tek diskutime të tjera. Kemi gjë?
Pranvera Begolli: Kryetar kam unë diçka. Po aktualisht për t'ju bërë në dijeni anëtarëve të këshillit që janë dhe pjesë e asamblesë, ne kemi marrë në datën 25 një vendim për këshillin mbikëqyrës. Ai vendim rrëzohet sepse ka dalë një VKM e re që të drejtën për të dhënë emrat për anëtarët e këshillit mbikëqyrës e ka ministria. Ka dalë vendimi 498 datë 26.06.2026. Kështu që dakord mund ta bëjmë do bëhet ajo dhe ne nuk kemi më të drejtë për të marrë pastaj asambleja emra që dërgon ministria është e shfuqizuar. Mund ta bëj një sekondë pse nuk u zbat ai vendim. E para dhe e dyta që është më kryesore për mua. Unë kështu e mendoj. Ju e bëni si të doni. Do dëshiroja të gjithë bashkëpunimin e këshilltarëve sepse do thoni jemi të vonuar ose s'duhet ta bëjmë. Po unë do kisha dëshirë që këshilli i bashkisë të bënte një peticion në mbrojtje të qëndrimit të bashkisë si bashki në Maliq. Mbyllur apo mbyllur nuk e di. Problemi është që duhet të lëvizim dhe me qytetarët, të lëvizim me të gjithë sepse s'kemi pse bëhemi ne vasal të Korçës.
Ornildi Demollari: Ke shumë të drejtë. Ke shumë të drejtë.

Pranvera Begolli: Mbledhja bashkia tonë ka forca të tilla, ka të gjithë tokat bujqësore, të gjithë ato. Kështu që unë mendoj që ne si këshill bashkie t'i dërgojmë qeverisë një peticion.

Ornildi Demollari: Mbledhjen e radhës mund ta sjellim për miratim nëse. Faleminderit.

Faslli Zholi: Kam nja dy gjëra.Në pikën 10 para se të para se t'u japim fjalën edhe atyre familjarëve që janë aty. Para se t'u japim fjalën atyre familjarëve që janë aty që i shikoj dua të them nja dy gjëra dhe i kam me ekzekutivin prandaj zoti mund të marrësh ndonjë shënim. Në këto të ndryshmet unë dua të dal tek rrugët që edhe u diskutuan një çik më përpara edhe po marr konkretisht rrugën e Mesmalit që është dhe rrugën e Moglicës. Ne shumë pak i dimë dhe u bëj një investim. Çfarë duhet ekzekutivi tashti që ta çojë në fund atë punë duhet që të bëhen kanalizimet siç u tha dhe nga kolegët edhe ju e dini vetë që e kemi lënë në mes se procesi i shirave mund të na nxjerri prapë ku ishim hiç asgjë. Prandaj është kërkuar dhe me Fetahun kam komunikuar dhe me kryetarin kam komunikuar që të vejë Fadroma të futen ato tubët ku ka mundësinë se i kanë gjetur privatisht si do të bëhet ku ka nevojë për ndonjë tubë të bëhet ajo kanalizimet. Këtë mbajeni me kujdes dhe duhet t'ua bëni sa më parë. Mos presim të vijnë shirat e

vjeshtë se të humbasë çdo gjë. Së pari. Së dyti kam disa ankesa nga qytetarët prapë në lidhje me rrugën dhe me shërbimin se qytetarët kur paguajnë shërbimin për ndriçim, për pastrim, për gjëra paguajnë taksat. Ne do t'u japim shërbimin. Po flas konkretisht në Libonik. Rruga që unë jetoj dhe poshtë e lartë është diskutuar disa herë për t'u bërë disa rregullime të cilat janë prishur për faj të ujësjellësit. Është bërë gropa gropa. Nuk është bërë. Është thënë që do ta bëjmë për të marrë disa tubë dhe më e keqja pastaj më poshtë që nga Vakëfi poshtë e di nuk kam folur edhe me Rudinën po më thuhet që nuk ka sensorë për ndriçim dhe është në bile kisha rënë ndonjë burrë atje ka thyer dhe krahun në atë lagje është errësirë fare fare nuk ka tani paguajnë taksat se s'ka tenderi s'ka çfarë rruge mund të ndjekin këtë duhet ta kini parasysh për ndriçim dhe një problem tjetër që më është ankuar mua një miku im edhe e din e ka shtëpinë e vjerrit për kazanin e plehrave kazani i plehrat aty njëri lindet te dera tjetri këtu ja vinte te dera dhe ka një konflikt unë ndërhyra dhe e kam vënë në një vend atje të cilët nuk i përket as X-it as Y-it dhe është mirë atje por duhet të shikoni që ku ka mundësinë te kazanët të bëni një kornizë që të jetë i futur kazani dhe të jetë vendi i caktuar mos e marrin ta heqin dhe të ndodhin tërë këto përplasje se ka përplasje aty në një diçka tjetër kam dhe një qytetar tjetër nuk e di a ka erdhur sot kërkesa këtu ka bërë kërkesë për sa i përket ujë në Memël. Është një familje e cila dhe nuk ka marrë ujë. Ka vite që kërkon ujë për të larë duart se po bën një ndërtim. Është biseduar dhe me ekzekutivin. Nuk e dimë se deri ku është. Ai është Axhi i Elmazi me të ndryshme dhe në të ndryshme. Tjetër që desha të të thoja këtu kemi dhe për sa i përket rrugës të varrezave të fshatit të për ujin e i varrezave të fshatit të Rov që s'ka ujë. Më kanë kërkuar që nuk ka ujë në fshat në varrezat edhe po edhe Liboniku është pa ujë në varrez në varrezat e Libonk po kështu më thanë që nuk kemi ujë dikushi që në gjë ashtu ndjesë kurse Liboniku në varrezat nuk ka ujë edhe këtë duhet ta keni parasysh kaq kisha unë për të thënë dhe kam dhe një diçka tjetër me sa i përket kanalizimeve të brenda që i keni juve të bashkisë në tokat, toka unë vajta atë ditë jo veç se është toka time e tërë janë kanalet të papastruara kanë vite pastrojnë se po vjen vjeshta do mbyllet toka ishte e përmbytur e timja të gjithë të tjerët bëjmë nja dy kunjtal grurë për hektar për dynym një turbë atje po edhe kanali është i papastruar prandaj merrni masat që të pastrohen se po vjen vjeshta edhe një urë që është aty që lidh drithasin me atë duhet të bëhet që të lidhet fare kollaj atje pse të dridhen njerëzit që janë andej kështu është e kemi kërkuar që të lidh drithasin me sheqerasin është në mes rrugën e keni shtruar këtej pastaj unë.

Serever Xhuti: Faleminderit kryetar kështu kisha për këto kryetare bashkisë për ujësjllësin e Zvezdës që s'po vjen ai ujë ka dy muaj që është bërë edhe se ai kërkon për varrezat ne s'kemi gjallët njëherë.

Zv/Kryetari i Bashkisë;z.Eridion Rustemi: Mua më vjen shumë mirë që këshilltarët e opozitës kanë kohën e mjaftueshme për t'i shprehur të gjitha shqetësimet edhe për këtë e ndjehem shumë mirë ë disa nga shqetësimet mendoj që me shumicën e këshilltarëve ne kemi komunikime të opozitës flas kemi komunikime të drejtpërdrejta edhe si ekzekutiv dhe disa vogëlsira ë mendoj që mund t'i komunikojmë edhe në përditshmëri sesa t'i sjellim në përmbledhjet e këshillit bashkiak

por shumë mirë bëjnë që vijnë këtu po e nis nga fundi shqetësimi i ngritur nga ë zoti Server Xhuti për sa i përket ujësjellësit të fshatit të Zvezdë aty sapo ka përfunduar është drejt përfundimit ë projekti i realizimit të rrjetit të brendshëm të ujësjellësit të fshatit Zvezdë dhe një shpimit të një pusi që ë nga verifikimet e fundit nuk ka dalë me kapacitetin e nevojshëm të ujit dhe për këtë arsye ka pasur edhe furnizim në testim sepse ai nuk është marrë në dorëzim akoma në testimin e furnizimit me ujë por mendoj që shumë shpejt do t'i gjendet një zgjidhje me shtimin e një pusi tjetër apo dhe me një lidhje alternative që po e mendojnë specialistët e ujësjellës kanalizimeve të ë ujësjellësit rajonal Korçë

Serever Xhuti:Më falni pse s'merret ne mulliri ne atje kemi kaq 11 litra në sekondë del e kemi me vaskë ne kemi bërë pse s'merret atje unë s'e marr vesh.

Zv/Kryetari i Bashkisë;z.Eridion Rustemi: Ke të drejtë ne ja kemi sugjeruar sepse kemi komunikuar edhe me juve apo me komunitetin siç edhe juve jeni në dijeni dhe besoj që do zgjidhet shumë shpejt e di që është një problem edhe unë kam komunikuar edhe dje me titullarin e bashkisë me kryetarin edhe ai e ka transmetuar tek ujësjellës kanalizimi Korçë sepse ujësjellësi tashmë nuk është më në për sa i përket problemeve në bujqësi në ujitje kullim në pastrimin e kanaleve ne po ju rikthehemi për herë të dytë edhe për herë të tretë konkretisht nuk e di ë zoti Zholi ku e keni problemin ta mbaj shënim do ta do ta kem parasysh do t'ju komunikoj por ne siç edhe ju jeni ju jemi rikthyer për herë të dytë e për herë të tretë.

Yllson Ibrahimllari: Atëherë i nderuar nënkryetar këshilltarët marrin hapësirën e duhur faleminderit për kënaqësinë e mbajtjes së mirë të opozitës do të doja nga ana juaj t'i kërkoni drejtorisë së pyjeve dhe kullotave pranë bashkisë Maliq të respektojë delegimin e kompetencave nga ministria e turizmit dhe mjedisit për hartimin dhe korrigjimin e planit të mbarshtrimit të ekonomisë pyjore Mesmal Lozhan sepse është një kompetencë që e ka vetë drejtoria që ja sjell këshillit, këshilli e miraton vitin e kaluar kemi harxhuar shumë kohë dhe shumë investim nga të gjithë ju sidomos nga ekzekutivi për korrigjimin e një gabimi hartografik ju lutem tashmë ajo zonë më fal ju lutem ajo zonë ka një problematikë që në regjistrimet e pasurive të tokës bujqësore të përfituar nga ligji 7501 i datës 19. 7.1991 vera se pastaj thua jo se tha partia jo komision i ka s'kam asgjë tani të lutem dëgjoje tjetrin për kënaqësi atëherë të thashë ministria e mjedisit dhe e turizmit i ka sjellë drejtorisë pyjore mbas verifikimeve ku vajtëm ashtu vazhdo ironi edhe një çik më lart po mundesh se të bën mirë për variçet, atëherë duhet të sjellë drejtoria këshillit planin e përgjithshëm planin e mbarshtrimit të ekonomisë pyjore mesmal e ka këtë kompetencë që ja ka deleguar ministria e konstatoj gabimin ta sjellit ta miratojmë në qoftë se presin organizimin e ri në bazë të agjencisë kombëtare të pyjeve me versionin e ri dhe nuk do jenë më nomenklatura e bashkisë e kanë gabim se këtë do ta këtë plan do ta miratojë ky këshill brenda këtij mandati. Faleminderit.

Ornildi Demollari: Dakord. Faleminderit. Klarsen ke diçka te kjo. Hajde do të duhet mikrofon. Hajde.

Lulëzim Hoxhaj: Kisha o nënkryetar ë kisha që bëri dhe Fazliu për sa i përket atyre kanaleve pasimit të kanaleve për për bujqësinë në fushat dhe poshtë është po ka të drejtë dhe është ashtu është me fjalë që ka probleme problematika po unë dua t'ju sjell vetëm një gjë në vëmendje po të kalosh Sheqerasit drejt Bregasit në krahun e djathtë është një urë ajo ura tani është në ajër 2 metra e distancuar nga toka që do të thotë nuk ka ç'i bën asaj zone dhe disa territoreve aty nuk ka ç'i bën as kullimi as thellimi aty e vetmja masë që mund të merret është vetëm ribonifikimi do shumë lekë nuk ka ç'i bën le të bëhen kanale ashtu 2 metra e ca ishte ai e kemi parë para tre katër muajve që në nëntor kur vajtëm atje për përmbytjet besoj që dhe sot e kësaj dite ka zona të përmbytura që nuk ka ikur uji akoma. Kështu që fjala kullim është pak e për këtë zonë them bonifikimi i kalon mundësitë e bashkisë lur i kalon pra në rregull dakord po që është bashkia bashkia ka bërë të vetën bashkia është ajo që do ta inicojë ta të kërkojë të ashtu ose ose një propozim tjetër atyre banorëve që janë në zonën e Sheqerasit dhe që e kanë këtë territor t'ju thuhet që mos mbyllni me këtë pandesë ajo do bëhet prapë kënetë bëhet lehtë bëhet kënetë edhe të mos mbillet me dhe të kthehet ashtu siç ka qenë ta bëjmë.

Përgjegjës i Sektorit të Pyje-Kullota; z.Klarsen Brako: Desha të sqaroj nga diçka se kjo është një histori shumë e gjatë ne e kemi diskutuar shumë herë po puna është që nuk pengohet asgjë nga bashkia neve ju bashkuam komisionit të ministrisë në mbështetje ë për të verifikuar rrjedhën e lumit vajtëm e verifikuam komisioni i dërgovi raportin e saj ne ja përcollëm agjencisë së pyjeve sepse ekziston një drejtori në brenda ministrisë dhe agjencia e pyjeve që është si drejtoria e jashtme që merret me politikat e pyjeve për fat të mirë e të keqe drejtori që ishte në inspektimin i grupit të punës në ministri çështje muaji kalovi në akp u përball prapë me dokumentin e tij nuk e mori parasysh dokumentin e tij ja nisëm ministrisë së mjedisit ndryshoi drejtorin na thotë bëheni vetë si bashki si bashki ne nuk bëjmë plane menaxhimi nuk miratojmë plane menaxhimi neve thjesht sepse planet e menaxhimit nuk i kemi bërë neve edhe diçka tjetër plani i menaxhimit nuk ndan toka nuk ka lidhje fare me tokat që të hipoteka nuk i merr për bazë hartat e planit të menaxhimit për të ndarë tokat hipoteka ka instrumentat e saja për të dhënë çertifikatat e tokave **Ornildi Demollari:**Mirë faleminderit atëhere.

Yllson Ibrahimllari:Të sqarojmë ministria i ka thënë ta bëjë bashkia nuk e miraton bashkia e miraton këshilli nëse s'kemi të çelim fondin ta bëjë një kompani private rregullimin e planit e të vendoset fare thjeshtë s'ka ka gjetje nëse ai fle aty pa e ngacmuar mos thonë pastaj rëmoni Yllsoni thoni ju thoni, Yllsoni s'ka filluar të rëmojë në këtë bashki faleminderit.

Ornildi Demollari: Kemi gjë tjetër tek diskutime të tjera atëhere kalojmë tek kërkesat dhe ankesat që janë drejtuar kishe gjë Klarsen?

Përgjegjës i Sektorit të Pyje-Kullota; z.Klarsen Brako: Unë jam shumë dakort të bëhet gjithçka nuk e di pse ngelet me mua.

Ornildi Demollari: Dakord kalojmë tek kërkesë ankesat që janë drejtuar këshillit të bashkisë ankesë kërkesë nga zoti Hajri Qemali në Libonik unë zoti Hajri Qemali kam një problem me supermarketin Spar në fshatin Libonik atë ata kanë vendosur 9 gjenerator ngjitur me pronën time kërkoj që që ato t'i spostojnë sepse është shumë shqetësuese ku kam lajmëruar dhe njësinë administrative libonik edhe policinë bashkiake por nuk ka marrë zgjidhje dhe ja ka drejtuar këshillit bashkiak.

Petrit Kupe: Unë di që ata të shparit po bëjnë përpjekje të t'ia blejnë hyrjen atje kështu më kanë thënë dhe mua se i njoh po t'i ble t'ja blejnë t'i blejnë hyrje tjetër me kupton t'i blejnë hyrje tjetër.
Ornildi Demollari:Të lutem nënkryetar përsëri me policinë bashkiake ndoshta gjendet një zgjidhje.

Zv/Kryetari i Bashkisë;z.Eridion Rustemi: Do ta rishikojmë mendoj që ka nevojë edhe për struktura të tjera jashtë bashkisë do ta shikojmë po mendoj faktikisht e dimë atë ajo është mendoj që ne jemi në favorizimin e bizneseve për zhvillimin e aktiviteteve të tilla që zona të ketë.

Ornildi Demollari: Një kërkesë tjetër ta marrim parasysh ë drejtuar këshillit bashkiak Maliq për dijeni ekzekutivit dhe kryetarit të bashkisë zotit Gëzim Topçiu unë i nënshkruari Haxhi Shahin Elmazi i datëlindjes 28.01.1961 lindur në fshatin Memël bashkia Maliq kërkoj si gjithë qytetarët e tjerë kam nevojë për ujë të pijshëm në pronën time dhe banesën time të cilën paguaj edhe detyrimet si gjithë qytetarët e tjerë problemi qëndron sepse është bërë riparimi i ujësjellësit dhe mua më kanë anashkaluar dhe më kanë lënë pa ujë me dashje apo arsye të tjera nuk e di por unë jam pa ujë kërkoj të më krijohet mundësi të marr ujë kundrejt çdo pagese sipas rregullave ngelem në zgjidhjen e këtij problemi nga ana juaj me respekt Haxhi Elmazi është një është një banor i zonës të Libonik të Zbogjerisë i cili kërkon ujë.

Petrit Kupe: Me sa di unë ujësjellësi është menaxhohet nga vetë fshati Zboq dhe është ndërtuar nga fshati Zboq.

Zv/Kryetari i Bashkisë;z.Eridion Rustemi: Mendoj që duhet të shikojmë për ngritjen e një komisioni që ta vlerësojë e kërkesën edhe kundërshtimin e këtyre banorëve që kanë erdhur këtu
Faslli Zholi: Dua të shtoj një diçka para se më fal tashti nuk u njoh as atë jam i që je kryeplaku juve ashtu bukur do bëj vetëm një pyetje pa paragjykuar as iksin as yin je kryeplak je në atë zonë të tërë kemi të drejtë?

Kryetari i fshatit Zboq: Uji të zboq dhe neve i kemi lënë një çezmë ujit është bërë me kontribut vullnetar një minutë mbasi e kemi bërë për herë të dytë tashi erdhi mirë më erdhi mirë kur thoje ujit është pronë uji po kanali edhe ato është prona tonë mirë shumë mirë tulpja e zboqit kërkon ujë Faslli pse s'i dha bashkia e Maliqit po i bëri impursete dhe ja bëri burimin atje ajo e ka burimin në te shtëpia e tij ku ka marrë për 50 vjet ujë ajo që na kërkon atje ku kemi punuar neve me vite të tëra dy vjet rresht kam punuar unë me traktor me punëtor ja ku janë le të ngrihen kur është prishur një çesë i kemi lënë atij që ka ajo ishte te mend kur filluan punime i thanë ne do të

lëmë një çesë hajde të punosh me ne ka paguar lek për bashkime për markuç se bashkia na dha një copë markuç ore nuk na dha 7 km pjesën tjetër e kemi blerë ne i paguan dhe ajo është delxhi **Faslli Zholi:**Dëgjo pak dëgjo mos nuk do të thyejmë njëri-tjetrin dëgjon edukata na vjen shumë dëgjo unë të unë të them një diçka më dëgjo them një diçka se jemi shqiptarë mbi të gjitha dhe ti je kryeplak po dhe kur ke je kryeplak duhet të diskutosh edhe për x-in edhe për e do apo s'e do po sepse do të zgjidhim dhe një gjë brenda rregullave dhe ligjeve po a është më të mirë dhe konsensusi tuaj aty në atë komunitet në qoftë se janë harxhuar kaq lekë dhe ajo të jetë atje me ju e të paguaj lekët ai ka paguar lekë s'kemi nevojë për po s'ke nevojë se ti s'ke po derisa ka shtëpi atje dhe unë do vetë në dushar mos kem ujë në dushar unë unë jam vet dush ti le të vijë në zboj të blej ti mos më japin ujë mua ata atje po jo ajo të na dali përpara neve meqë unë unë atje të marrja ujë me gjithë se me gjithë respekt linja atje të marri ujë që arrat nuk ka shtëpi më dashur miqësisht shoqërisht po të kërkoj që qetësohuni dhe zgjidheni këtë problem sepse është e drejta e çdo qytetari të marri ujë nuk ka zgjidhje kjo qëndron është e vërtetë nuk ka zgjidhje sepse tani të flasim ky është delegë ky është kështu po çfarë don për ty e për xin nuk do t'i po me gjëra të **Ornildi Demollari:**Dakord dakord ulu qetësoju se keni erdhur me shumë me disa banorë me sa shikoj po vetëm fshati jo fshati një pjesë e fshatit tani këshilli normalisht paraqitet një kërkesë që kërkon ujë edhe në pamje të parë këshilli pajtohet me zotërinë, gjykoj ju lutem gjykoj të ngelemi me atë sugjerimin e nënkryetarit të krijohet një komision të mblidhen të gjithë të dyja palët.

Idlir Limllari:Përshëndetje për rastin në fjalë mendoj që ankesa ose kërkesa t'i dërgohet drejtorisë së ujësjellësit në qoftë se ujësjellësi menaxhon atë si fshat është privat fshat më fal ne duhet të dërgojmë kërkesën e ujësjellësit dhe të presim përgjigjen në qoftë se menaxhohet në qoftë se më falni të flas unë pastaj mirë qoftë që menaxhon në qoftë se ajo menaxhohet nga ujësjellësi ujësjellësi do t'i japë ujë në qoftë se nuk menaxhohet nga ujësjellësi zotërisë t'i kthehet përgjigje që në filan zonë nuk menaxhohet nga bashkia nga ujësjellësi të zgjidh zgjidhje alternative.E kuptova le ta zgjedhin në gjykatë le të shkojnë në gjykatë po ja marr shpinë vetëm ujë.

Yllson Ibrahimllari: Ju lutem i nderuar kryeplak, atëherë unë mendoj që këto kërkesat që ne na vijnë nga banorët nga komuniteti që nuk janë specifike për ndërhyrjen e këshillit siç na vijnë projekt vendimet këtu të hartuara të kalojnë në drejtoritë respektive të ekzekutivit dhe pastaj kur shoqërohen me një relacion dhe ne të dimë të orientohemi qytetari ka të drejtë të ketë të mos pengohet në jetesën e vetë ne do japim opinionet tona relative por në fund të fundit nuk jemi specialistë të fushës se duke marrë ankesat që i trajtojmë në fillim ne çfarë bëjmë ja lëmë nënkryetarit për të bërë zgjidhje dhe nënkryetari ja çon drejtorisë dhe më mbrapa na vjen prapë shpjegimi ose ngelemi këtu dhe ato shkresa vetëm sekretohen kështu që mendoj që kërkesat që vijnë pavarësisht se janë për këshillin kur janë kërkesa që i shtrohen paralelisht dhe ekzekutivit kur vijnë nga drejtoritë përkatëse me një relacion atëherë është t'i paraqiten këshillit faleminderit

Ornildi Demollari: Petrit kishe gjë kalojmë tek tjetra

Petrit Kupe: Isha në një fjalë me doktorin nuk mund ta vendosim ne tashi jemi përballë dy dy palëve përballë një shumice që është fshati përballë një personi që ka të drejtë të kroju kjo kërkesë ta drejtësoheshe gjen në institucionin e ekzekutivit gjykonin ata dhe.

Ornildi Demollari: Nga ekzekutivi ka erdhur mbase ka erdhur me idenë që direkt nga juve kërkesa jo nga ekzekutivi është edhe nga ekzekutivi ka ardhur nga ekzekutivi ekzekutivi t'i jap një mbase këshilli merr një vendim domethënë në kuptimin s'ka s'ke projekt vendim s'kemi projekt vendim nga nga.

Yllson Ibrahimllari:Këshilli këshilli ka një vendim t'i pagohet kishës çfarë i takon kishës dhe Çezarit çfarë i takon Çezarit këshilli ka vetëm një vendim vini lekët t'i bëjmë zotërisë një pus atje te shtëpia të marri ujë asnjë gjë tjetër.

Ornildi Demollari:Të lutem nënkryetar ngelet prapë.

Zv/Kryetari i Bashkisë;z.Eridion Rustemi: Kaloja sekretariatit ta çojë tek zyra e ankesave të ngremë një komision ta shqyrtojnë edhe njëherë e t'ja sjellë me relacion përgjigjen që t'ja komunikoni edhe zotërisë.

Yllson Ibrahimllari: Kryetar të lutem është atje të bëj i nderuar zoti zoti nënkryetar kemi pranuar aplikimet për paketën e maleve në male njeri pa ujë dhe pa lumenj nuk ngjitet se nuk rriten as bagëtitë ku s'ka ku është shteruar lumi dhe s'kanë ku pinë dhe po s'pati ujë ai njeriu nuk ngjitet tani këtë vit jemi të hapur dhe kërkojmë investime këtë i ndalojmë një njeriu që ka bërë një baç me arra të mos ketë ujë, o Koli të lutem ujë i pishit nuk kalon për patjetër ti je i zgjedhur unë jam i zgjedhur kemi respekt dhe jemi dhe krush bashkë mirë kur i kemi diskutuar ato problemet 27 vjeçare edhe ti i ke nja tre mandate je jashtë rregullores.

Ornildi Demollari: Faleminderit mirë vazhdojmë tek ë ta mbyllim këtë çështje ju lutem e mbyllim këtë këtë çështje kalon prapë te ekzekutivi ndoshta me një komision apo ta shikoj ekzekutiv gjykatës dakord dakord mirë dokumenta. kalojmë tek drejtohet gjykatë ju lutem ju lutem drejtohet më le ta marri do zgjidh jeni të bindur që do zgjidhet të nderuar banorë të zonës atje faleminderit që erdhët u lodhët nuk këshilli nuk nuk bëri vendimmarrje për këtë pjesë kërkesa e zotërisë i kalon prapë ekzekutivit faleminderit ë kalojmë te kërkesa tjetër ë të kërkesë të nderuar kemi dhunë Emanuel Qyçllari pronari i një banese në fshatin Velçan njësia administrative ë më falni lënda kërkesë për evidentimin e dëmeve të shkaktuara në banesë kryerjen e eksperti teknik dhe gjeologjik përcaktimin e shkaqeve të dëmtimit marrjen e masave emergjente për mbrojtjen e jetës dhe pronës si dhe përfshirjen në programet e kompensimit dhe rehabilitimit sipas legjislacionit në fuqi pra zoti Emanuel Çuçllari pronari i një banese në fshatin Velçani njësia administrative Gorë po ju drejtohem për të kërkuar ndërhyrjen tuaj të menjëhershme për mbrojtjen e jetës dhe pronës time si dhe për verifikimin e dëmeve shumë të rënda të shkaktuara në banesën time për një periudhë mbi shtatëvjeçare kam qenë duke vuajtur dënimin penal në institucionin e ekzekutimit të vendimeve penale Drenovë të cilin e kam

përfunduar rreth tre muaj më parë gjatë kohës që unë ndodhesha në vuajtjen e dënimit konkretisht në periudhën nëntor 2025 janar 2026 në zonën ku ndodhet banesa ime kanë ndodhur reshje intensive dhe prurje të mëdha ujore të cilat kanë sjellë dëmtime shumë të rënda në pronën time. Pas kthimit në banesë kam konstatuar se lumi ka gërryer në mënyrë të konsiderueshme truallin përpara banesës dhe një pjesë e konsiderueshme e tokës është shembur. Shtrati i lumit është afruar në mënyrë të frikshme pranë objektit. Banesa ka pësuar dëmtime serioze dhe ndodhet pothuajse jashtë kushteve normale të banimit. Salla e baktive është shkatërruar pothuajse tërësisht dhe është zhdukur nga arta plotësisht nga rrjedha e rrëmbyer e ujit të lumit. Ekziston rrezik real që në rast rreshjesh të tjera objekti të pësojë dëmtime dhe më të mëdha ose të shembet fare. Fotografitë që bashkëlidhen tregojnë qartë gjendjen aktuale të banesës dhe dëmtimet e pësuara. Nga vlerësimi im dëmet mund të jenë shkaktuar nga kombinimi i kushteve të rënduara atmosferike dhe faktorëve të tjerë që lidhen me administrimin e prurjeve ujore në zonë përfshirë funksionimin ose shkarkimet e mundshme të digës së Hecit kasollet e Selcës. Nuk pretendoj se ky është shkaku i provuar. Unë kërkoj që kjo mundësi të hetohet dhe të verifikohet nga organet kompetente nëpërmjet një ekspertimi teknik dhe administrativ të pavarur. Nga informacioni që kam, strukturat vendore të emergjencave civile kanë kryer verifikime në zonë, por dëmtimet e pronës sime nuk janë evidentuar dhe pasqyruar në mënyrë të plotë, duke bërë që deri më sot të mos përfitojë asnjë masë mbështetëse. Gjendja aktuale e banesës përbën rrezik serioz për jetën, sigurinë dhe pronën time. Baza ligjore thotë ku e mbështet kërkesën Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, ligji 45219 për mbrojtjen civile, ligji 139/2015 për pushtetin vendor, ligji 44215 i procedurave administrative, legjislacioni shqiptar për mbrojtjen e pronës private dhe të drejtën për administrimin e rregullt. Për sa më sipër kërkoj të ngrihet menjëherë një grup pune për evidentimin e dëmeve. Dy, të kryhet një eksperti teknik nga inxhinier ndërtimi për të përcaktuar nëse banesa është e sigurt për banim. Tre, të kryhet një eksperti gjeologjik dhe hidroteknik për të përcaktuar shkaqet e gërryerjes së truallit. Katër, të hetohet në mënyrë të pavarur nëse dëmtimet lidhen me fenomene natyrore, administrimin e prurjeve ujore ose faktorë të tjerë si për shembull si ndikon diga e Hecit në dëmtimet që ka pësuar banesa ime. Mbasi këto shqetësime kanë filluar në zonë pas ndërtimit të kësaj dige. Më përpara nuk kemi pasur fenomene dëmtimesh nga lumi në kllapa kjo të hartohet pesë të hartohet procesverbal në raport teknik për gjendjen e banesës. Gjashtë të merren masa emergjente për mbrojtjen e banesës nga dëmtime të mëtejshme. Shtatë të kryhet një sistemim për mbrojtjen e brigjeve të lumit. Tetë të përfshihet në çdo program shtetëror kompensimi dhe rehabilitimi që parashikon legjislacioni. Nëntë të vihet në dispozicion çdo procesverbal, raport ose akt administrativ që është hartuar për dëmet në zonën ku ndodhet banesa ime. 10 të marrë përgjigje me shkrim në afatin ligjor dhe ka dërguar pastaj edhe fotot e banesës.

Pranvera Begolli: Kryetar, meqë se jam te pjesa e ligjeve, të lutem aktualisht ai i ka kapur shumë mirë nenet dhe pikat, por është një procedurë që duhet patjetër ta ndjekë ekzekutivi. Pra, ekzekutivi të ndjekë gjithë procedurat siç i bën për të gjitha ndërtesat, siç i bën për të tëra. Edhe ai më duket ka qenë perfekt, i ka ditur shumë mirë ato nenet dhe ligjet dhe bravo i qoftë. Dhe në

qoftë se vërtetë qëndrojnë ato, ekzekutivi t'i vërë gishtin kokës dhe t'i verifikojë. Nuk ka pse marrim kjo është e Nidlit dhe kjo është e Erit ose kjo është e Verës dhe kjo është e Erit. Në rregull.

Yllson Ibrahimllari: Po se po bëhet fjalë për Velçanin. Tashi u bë fshat i madh në këtë këshill bashkiak. T'ju jap dy të dhëna. Me sa kam unë dijeni se në atë periudhë ka jetuar nëna dhe babai im atje dhe jo unë. Unë isha në shkollë dhe mbas shkolle në punë. Kjo shtëpi është ndërtuar diku nga vitet 2000. Është një banesë dy katëshe në katin e parë me mur guri në trashësi të konsiderueshme ajo poshtë rrugës. Atje ku keni atje më fal kur përfaqësuesit e ekzekutivit kanë ndenjur mbi 10 ditë për të rregulluar rrugën. Është një komunikim i imi drejtpërdrejtë në përmbytje në media sociale, jo tek ju. Është një komunikim i imi me kryetarin e bashkisë në mënyrë telefonike. Është një komunikim i imi deri në shurdhëri të tepërt me çdo përfaqësues në grupet e punës tuaj. Vajti Murati, vajti Renaldoja, vajti dhe Andi Sulo. Grupi i parë vajti, grupi i dytë, i tretë. Kush i drejtonte grupet i di më mirë se s'dua të merrem me këtë pjesë. Dhe diku me shkrim dore u tha është dëmtuar dhe shtëpia e Ylli Ibrahimllarit. E keni në listët e kompensimeve të dëmeve shtëpinë e Ylli Ibrahimllarit. E para unë e kam emrin Ylson dhe kërthizën s'ma ka prerë njeri me përjashtim të Verës që i lejohet. E dyta në asnjë lista që i ka shkuar ministrisë dhe agjencisë të mbrojtjes civile emri im nuk ekziston. Nuk ekziston asnjë emër nga Velçani se ka dhe të tjerë që kanë pasur toka me qeraj ju kanë sjellë asgjë personale me ju dhe ti je jashtë kësaj gjëje. Je ngjitur në fshat lart kur ke parë rrugën e fshatit në ato ditë ke vajtur. Kjo banesa është 10 m nga rruga e dëmtuar. Gjysmën ja mori shtrati i lumit. Se çuditërisht lumi i Velçanit që vjen nga Osnati dhe nga Mesmali i nxjerr gjithë gurët e mëdhenj vetëm poshtë digës. Sipër digës nuk ka asnjë gurë të madh. Tani se lidhet kjo a s'lidhet kjo me hapjen e digës. Unë s'dua të bëj ekspertizën dhe nuk dua të cënoj askënd në raportet e veta. Edhe kompania ndërtuese është më afërt familjarisht me mua sesa me ju. Ky banori ka qenë në burg dhe ne nuk i kërkojmë dot llogari pse nuk ka qenë pjesëmarrës që të na tërhiqte nga mengët. Edhe unë i ndodhur në një fat tjetër sepse nëna e këtij zotërisë është goca ime e xhaxhait që jeton në emigracion në Greqi dhe ai sa doli nga burgu vajti te ejama. Po duke thënë që shpesh herë më thonë që kam ardhur për hallet e mia dhe unë s'e hapa gojën. Merrja në darkë shefin e emergjencave civile më thoshte s'e kam unë. Merrja një zotëri tjetër këtu thoshte s'e kam unë. Emergjencat nuk e paskan për ta konstatuar bujqësia se paska pemëtoren time të Azhbëresë. Në listat që janë në ministri për kompensim Velçani dhe Mesmali nuk ekziston gjëkundi. Bëj një pyetje i nderuar nënkryetar. Për çfarë i keni çuar emergjencat civile? Mos i kemi futur në qorrsokak dhe kanë vajtur për të rregulluar rrugën e Mesmalit se gjynah që shteti të harxhojë lekë. Ajo shtëpi është e pabanueshme. I nderuar kryetar, nuk e bëjmë ne ekspertizën nëse ajo banesë është e banueshme apo është në gjendje që të banojë. Ajo banesë ka një fatkeqësi që mbas vdekjes së të jatit të këtij zotërisë dhe këta dy djem t'u arrestuan për efekt të mbjelljes së kanabisit. Janë djemt e gocës time të Xhajës dhe unë nuk e fsheh këtë fakt se mund të dalë dhe nesër ndonjë pronar parcelet se çfarë s'bëhet këtë vërdallë, por gjithsesi e vërteta genetike vjen këtu. Të lutem për të ta sqaruar imtësisht. Nuk jam marrë me këtë banesë jo për interesin tim, po se do thoshin ka bërë një klan

doktori dhe ka vajtur. Duhet t'i drejtohemi institutit të ndërtimeve siç vlerësoj është i Idliri këtu dhe unë nuk mund të flas. Komisionet përkatëse janë DS1, DS2 të pabanueshme nga tërmeti të banueshme. Le ta sjellin ata çertifikimin. A ka bërë gjë që është marrë lumi edhe i ka marrë stallën? Po, stalla ka qenë e pambuluar. Muret ishin për gjysëm të rëna se ata s'mbanin blektori në këtë moment që ka ndodhur përmbytja se ishin shpërngulur. Se s'duhet të gënjejmë. Gjithë toka në terren është shtëpia është spostuar në planin horizontale rrëshkitur dhe muret e çara totalisht është e pabanueshme. Tani se u ngop nga poshtë me ujë dhe erdhi dhe një rrëke nga lart dhe shkyti gjithë masivit të këtë nuk jam unë për ta thënë. Ajo shtëpi është e pabanueshme. Ai zotëria duhet të vihet në listë. Kanë marrë le nga komuna çarë kanë pasur mundësi, kanë pasur energji të lidhur, kanë gjithë të drejtën të kthehen aty dhe të jetojnë jetën e vetë. Dakord? Kështu që në Velçan mazhorancën e keni ju dhe jo unë. Dhe kështu që unë vazhdoj t'i përkraq shëndetësisht asaj. Nuk kam asnjë gjë tjetër politike. Faleminderit.

Ornildi Demollari: Faleminderit. Idlir, ke ndonjë mendim për këtë?

Idlir Limllari: Mendimi im është komisioni nuk e di sa është i ligjshëm nga ana jonë edhe specialistë, por një komision, një verifikim të vërtetë të emergjencave të bashkisë.

Ornildi Demollari:Nënkryetar, merre një si rast.

Zv/Kryetari i Bashkisë;z.Eridion Rustemi: Patjetër ne do ta marrim në konsideratë t'i shikojmë ato pikat një pas një duke dëgjuar tek e lexoni ju disa prej tyre mbase janë edhe jashtë kompetencave të bashkisë të Maliqit për të kryer disa verifikime, inspektime. Po për atë që na përket patjetër do ta shikojmë. Ne për ne nuk ka rëndësi emri i personit që është i dëmtuar nga fatkeqësitë natyrore. Ashtu siç juve votuat para pak minutash listën me 46 familje që ne nuk i kemi parë fare me emra ashtu siç nuk i shikoni dhe ju, por thjesht shikojmë problemet e njerëzve. Të shikohet edhe ky rast edhe në qoftë se është në kompetencën e bashkisë për ta ndihmuar patjetër të sillet këtu apo të shkojë me strukturat tona dhe të ndihmohet rasti i djalit.

Yllson Ibrahimllari: Një sugjerim. Komisioni i emergjencave civile ka qenë atje. Kjo nuk bëhet kështu. I nderuar nënkryetar, ngrini një komision miks. Ë mos shkojnë të njëjtët personë që kanë vajtur. Se zakonisht kur qepim ndonjë plagë të keq edhe vijmë për herë të dytë mundohemi të ndreqim çfarë kemi bërë. Po të kishim vullnet për ta prerë ajo bënte mu po me brirë të mëdhenj ajo shtëpia aty para që në dhjetor dhe në janar.

Ornildi Demollari: Dakord. Ecim Petrit. Po ecim me kërkesa.

Petrit Kupe: Po nuk e di kur ka ardhur kërkesa. Po do të ishte mirë një përgjigje ndoshta nga komisioni që merren me emergjencat ta kishim. Megjithatë jam dakort me atë. Ai komision që ka vajtur herën e parë nuk duhet të jetë tani. Ata edhe për çështje karakteri do të mundohen të shmangen dhe të largojnë përgjegjësinë. Po bashkia ka mundësi të ngrejë një komision më serioz. Është një rast i rëndësishëm për flagrantë ashtu siç janë zhdomtuar dhe familjet e tjera

nga rreshqet e asaj periudhe. Ekziston mundësia që të zgjidhet ky problem ashtu si dhe të tjerat. Nuk besoj se ka nevojë për ministrira dhe dikaster të tjera.

Zv/Kryetari i Bashkisë;z.Eridion Rustemi:A lejon ligji ta shikojmë që në komision të përfshihet edhe një nga i gjithë komisioni i këshillit.

Petrit Kupe: Le të vijë se s'ka si specialist mund të vijë dhe Idliri.

Yllson Ibrahimllari:E dyta mbase ky djali duke dashur të krijojë familjen e re të shikojë te kreditë e buta të strehimit që ne nuk kemi aplikim ne kemi banesa në komision që s'bëhet aplikim.

Ornildi Demollari: Mund të vijë ai djali i bëjmë thirrje nga këtu që mund të vijë të të bëjë aplikim.

Yllson Ibrahimllari: Ai djali ka tre ditë që ka ardhur nga Greqia vajti të rritet te shtëpia 10 ditë po themi dhe bëri atë.

Ornildi Demollari: Po dakord më mirë se ka erdhur po përfitoj nga rasti që t'i bëj thirrje që të vijë të bëjë dhe aplikimDakord atëhere kalojmë tek kërkesat e tjera ë kërkesë drejtuar zotit Gëzim Topçiu kryetar i bashkisë Maliq dhe këshillit të bashkisë Maliq unë i nënshkruari Shaqir ju lutem Shaqir Hoxhallari banori i fshatit Kucak njësia administrative Moglic kam këtë kërkesë në datën 1 korrik 2026 isha duke kullotur bagëtitë time delet në mal dhe mbasdite filloi të binte shi i shoqëruar me stuhi dhe shkreptima elektrike ku delet ishin grumbulluar pas një peme një rrufe goditi tufën e dhenëve duke më vrarë 32 kreherë dele. Këto dele të ngordhura u verifikuan nga grupi i dërguar nga ana e bashkisë së bashku me shërbimin veterinar të rrethit të cilët vendosën që të groposeshin sipas rregullave. Mua mu shkaktua dëm i madh sepse me të ardhurat që siguroja prej tyre mbaja familjen. Ju lutem që të më ndihmoni financiarisht që të blej bagëti të tjera dhe të vazhdoj punën. Kam besim se kërkesa ime do të merret në konsideratë me respekt Shaqir Hoxhallari. A je bërë njerësi? Shaqiri është aty në fakt.I është dhënë shpërblimi për dëmin. Nuk i është dhënë. Po pse? Jo. Jo. Derisa për vlerësimin duhet të vijë një projekt vendim këtu. Jo, jo. Ne nuk kemi ai ka dërguar kërkesën më tani. Dakord.

Pranvera Begolli: Ju lutem ai thotë që kanë vajtur në organet kompetente kanë bërë verifikimin i kanë groposur në momentin që i groposin e kanë bërë vlerësimin këta zotërinj që kanë vajtur atje apo kanë vajtur në mur topi bëjnë vlerësimin dhe japin shpërblim.

Ornildi Demollari: Shaqir të dhanë ndonjë letër ndonjë vlerësim bën vlerësim ata komisioni s'të kanë dhënë gjë veteriner çfarë të thanë veterinerët?

Petrit Kupe: Vlerësim ore tashi tashi vlerësimi do të bëhet nga do të bëhet nga dëmtim do të bëhet nga ministria e bujqësisë apo do bëhet nga bashkia kjo gjë duhet ndarë kush e ka bërë përsërit kanë bërë veterinerët bashkia ziqen ata janë veterinerët janë institucion tjetër duhet ta të

lutem duhet ta dimë në qoftë se e ka bërë bashkia vlerësimin të bëjë çdëmtimin aq sa mendon në qoftë se e ka bërë ata veterinerët ta ndajnë këtë punë se ai po pret nga bashkia kur e kanë bërë vlerësimin veterinerët.

Ornildi Demollari: Ka qenë grupi i shërbimit veterinar thotë ai ka qenë po se ne s'kemi gjë si bashki veterinerët kanë faturuar dëme që ky dëme është ekziston dëmi nuk janë raportuar tani ky dë shkaktuar.

Lulëzim Hoxhaj: Nga një nga një fuqi natyrore e jashtëzakonshme llogjik jo llogjikisht po edhe me rregullat e tjera të tjera të tjera ky duhet të dëmshpërblejë kush e dëmshpërblen është tjetër histori pastaj.

Zv/Kryetari i Bashkisë;z.Eridion Rustemi: Kemi një rast rastin e disa muajve më përpara të një tufe të goditur nga ajo murtaja në Shkozë dhe dëshpërblimin ai e ka një sëmundje kjo atë e mburron ministri e bujqësisë epo prandaj duhet të shikojmë hapësirat ligjore sa na përket ne në rastin e zotërisë të shkollës kemi ju si këshill keni miratuar një fond si të themi solidariteti një çek nuk e di vlerën kush e ka për ta shikuar edhe për zotërinë të shkojmë hapësirën ligjore çarë na përket ne ta shikojmë mbase e ka ai shkohet për pjesën e dëmtimit është dëmtuar tani shpejt nga ministria e bujqësisë edhe ne mori një nga bashkia edhe nga bashkia diçka për rastin që ashtu edhe këtë duhet ta ta shikojmë si rast se mbase ai zotëria ka shyqyr shpëtove vetë njëherë se unë e di rastin edhe jam marrëuar.

Ornildi Demollari:Nënkryetar një sekondë ndoshta t'i jepet një përgjigje kërkesës ku t'i thuhet që jemi në këto kushte afatet janë shumë të shkurtra mbase për t'i kërk përgjigje se ka javë sa ka po me një me shkrim përgjigje me shkrim.

Yllson Ibrahimllari: Ju lutem nëse do të më lejonit mund t'ju sugjeroj një zgjidhje po për sa i përket këshillit ne të veprojmë siç kemi vepruar në rastet e fatkeqësive në atë shumë që kemi dëshpërblyer dhe të tjerët. Fatkeqësitë kur kanë ndodhur, sa ka qenë ajo tarifa që ne normalisht miratojmë si një gjendje karshi fermerit. Për sa i përket raportit të të sëmundjeve veterinare të groposura, ka legjislacion në fuqi. Për sa i përket fatkeqësive natyrore, duhet që ne të gjithë të bëjmë të bëjmë siguracion privat, sepse rrufeja nuk është shumë larg nga breshri që na dëmton qershitë, këtemat dhe prodhimet dhe s'kanë marrë asgjë asnjëherë ata fermerët. Pra, po ta fillojmë çik nga fillimi i gjesë për ta kapur siç duhet dhe për ta ndihmuar zotërinë. Të marrim këtë raportin veterinar, t'ia çojmë si bashki ministrisë, do kemi një përgjigje nga ata ka ose s'ka. Ndoshta një shumë pak më e modeluar se ajo që japim për një banesë të djegura, për një dëmtim ku ndodh diku tjetër që ne si këshill i kemi vendosur procedura dhe ne si këshill jemi në kapacitetet tona maksimale aq sa ç'na lejon buxheti jonë duke i dhënë një ndihmë zotërisë i cili ndodhet në këtë fatkeqësi. Po unë nuk besoj si këshill ne kemi mundësinë t'i bëjmë gjithë dëmshpërblimin nga buxheti i këshillit apo nga buxheti bashkiak. Ju faleminderit.

Zv/Kryetari i Bashkisë;z.Eridion Rustemi:Përfundimisht çfarë ë do komunikohet nga ana jonë me drejtorinë juridike dhe me personat që kanë qenë të interesohemi se nuk jam dijeni cili ka qenë nga bashkia se nuk e kam pasur në një në material kërkesën që zotëria do ishte sot këtu dhe jam i papërgatitur për momentin. Do interesohem për dokumentacionin që kemi ne. Do shkojmë në bazën ligjore juridike me juristët tanë. Çfarë na përket nga ana jonë mbase në mbledhjen tjetër të këshillit të shkojmë drejt asaj që tha edhe doktori për atë që na përket dhe sa kemi mundësi që juve i dini mundësitë financiare që ka bashkia në këto raste se ne nuk mund

Ornildi Demollari: Qemal do ta shikojmë si rast do të kthejmë edhe përgjigje do ta shikojmë edhe si rast për të në rregull faleminderit.

Petrit Kupe: Nuk e di ku është paraqitur për procesverbali a është në bashki apo s'është e para e dyta është shumë lehtë të komunikoni me ministrinë e po do komunikojmë pra me ministrinë do t'ju jap unë një numër kontakti është një kryetar i partisë socialiste Libonikut dhe duhet të komunikoni me Landi Meçin edhe ai t'i përgjigjet që e financon ministria e bujqësisë këtë rast apo nuk e financon në qoftë se nuk e financon ministria e bujqësisë se është kaq shikojmë mundësia ç'mund të bëjmë ne ç'mund të bëjmë ne dhe është e mundshme të të pagohet dhe do t'i themi flasim herën tjetër.

Ornildi Demollari: Zonjë çfarë kishe?

Pranvera Begolli: Zonjën e njoh unë në fakt a ka kaluar një sëmundje nuk njeh vetëm conin ti njeh dhe atë zonjë e njoh e njoh sepse ka qenë punonjëse dhe Rozafa ka qenë atje në pastrim ka kaluar një sëmundje të kancerit të gjirit dhe ka erdhur këtu për të kërkuar një ndihmë. Unë fola një çik dhe me Ermanën. Ermana thotë që ne jemi në kushte që këto që trajtohen me kimio i kemi të përgjithshme. Një përgjigje që s'di çfarë të them. Një gjë është se e di unë dhe se e kam ditur në shtëpia. Kështu që ylli si komision i shëndetësisë ylli mund të flasin çik më shumë.

Faslli Zholi:Më dëgjo tashi. Ajo zonja është komshi me mua dhe e njoh ka mbi një vit e ca që e vuan. Çfarë kërkon ajo për mendimin tim dhe familja e saj? Është me gjithmend për të ndihmuar. Por këto që po thoni ju doktore këto këto i di ajo i ka se bën akoma kimjo edhe është në ajo ka burrin i cili me tre muaj me tre muaj se po mos iki nuk i merr dot ilaçet. Tani çfarë mendoj unë këtu po e them këtu publikisht ai burri të kthehet këtu edhe t'i hapet një mundësi që ai burri është punëtor burri i nderuar brenda moshës nuk është në moshë të madhe gjendet një vend pune që ai t'i shërbejë asaj sa është vetë kështu e mendoj unë është rruga më e zgjidhshme që atij personit asaj familje t'i vihet në ndihmë duke e punësuar të shoqen që ajo të jenë të dy sa është vetë unë e kam ngjitur në shtëpi dhe e njoh më mirë nga të gjithë juve që jeni këtu kam 30 vjet që e njoh atë familjen dhe nuk ka kundërve e di unë edhe është një situatë të cilën unë e di edhe me mjekësinë e me tëra që ajo është në një situatë po si prend prandaj këtë mendoj unë një mendim kam tek jam punësuar shumë e shumë një janë se ti gjendet një vend pune.

Yllson Ibrahimllari:Në qoftë se përballoni listën e të sëmurëve me kancer në bashkinë e Maliqit si listë emërore që më mirë nga kushdo tjetër problematikat shëndetësore të ndjekjes ti Fazlli i njeh shumë mirë në sensin në qoftë se ne do rrimë edhe do bëjmë nuk po themi tani çfarë mund të bëjmë privatisht hapja e listës në mungesë të një legjislacioni do ta kthejë më pastaj bashkinë në këtë punë kështu që zgjidhja më e mirë është punësimi dhe ndihmesa pastaj edhe jashtë mikrofonëve nga ana jonë ju faleminderit, kjo është do gjej unë një do gjej unë një donacion të mundësive që kemi bërë për një zonjë në Pojan dikur që Lola thotë pse ma përmend.

Ornildi Demollari: Zonj të urojmë të shkuara do shikojmë mundësinë. Atëherë këto ishin për mbledhjen e sotme ju falenderoj dhe ju uroj ditë të mbarë në vazhdim.

Mbajtës Protokolli

SEKRETARI I KËSHILLIT

Gertjan GJIRITI

KRYETARI I KËSHILLIT

Ornildi DEMOLLARI